

VAKSINIME PËR TË GJITHË.

Vaksinat përforcuese të Pfizer kundër COVID-19

Pyetje të shpeshta

Vaksina përforcuese e Pfizer kundër COVID-19 rekomandohet për personat e kualifikuar që kanë marrë dozën e dytë të vaksinës së Pfizer kundër COVID-19 gjashtë muaj më parë e më shumë dhe që janë në rrezik të rritur ekspozimi ndaj COVID-19 ose sëmundjeje të rëndë COVID-19, duke përfshirë njerëzit e moshës 65 vjeç e lart. Vaksina përforcuese duhet dhënë gjashtë muaj a më shumë pas dozës së dytë të Pfizer.

Çfarë është vakcina përforcuese?

Vaksina përforcuese është një dozë shtesë e vaksinës për njerëzit që kanë krijuar mbrojtje nga vaksinimi, por mbrojtja e të cilëve mund të jetë ulur me kalimin e kohës (ky quhet dobësim imuniteti).

Kush mund ta kryejë vaksinën përforcuese?

Grupet e mëposhtme që kanë marrë dozën e dytë të vaksinës së Pfizer kualifikohen për të marrë vaksinën përforcuese të Pfizer gjashtë muaj pas dozës së dytë:

- + Njerëzit 65 vjeç e lart
- + Njerëzit që jetojnë në një shtëpi pleqsh ose qendër tjetër kujdesi afatgjatë
- + Njerëzit 18 deri në 64 vjeç që kanë problem ekzistues mjekësor që rrit rrezikun e tyre për COVID-19 të shkallës së rëndë

- + Njerëzit 18 deri në 64 vjeç që janë në rrezik të shtuar për ekspozim ndaj COVID-19 për shkak të punës së tyre (për shembull, punonjësit shëndetësorë dhe mësuesit) ose të vendit ku jetojnë apo që frekuentojnë shpesh (për shembull, një strehë për të pastrehët)

Përse rekomandohet vakcina përforcuese?

Vaksina Pfizer vijon të jetë efikase në parandalimin e sëmundjes së rëndë, shtrimit në spital dhe vdekjes për shkak të COVID-19. Por disa studime tregojnë se mbrojtja kundër infektimit nga vakcina e Pfizer mund të fillojë të bjerë pas rreth gjashtë muajsh. Vaksina përforcuese mund të ofrojë mbrojtje të mëtejshme për personat që janë në rrezik të shtuar për ekspozim ndaj COVID-19 ose sëmundje COVID-19 të shkallës së rëndë, sidomos me praninë e variantit Delta që qarkullon në komunitetet tona.

A ofrohet përforcimi për personat që kanë kryer vaksinën e Moderna ose të Johnson & Johnson kundër COVID-19?

Vaksina përforcuese e Pfizer ofrohet vetëm për personat e kualifikuar që kanë kryer dy dozat e para të vaksinës së Pfizer. Vaksina përforcuese e Pfizer nuk është e miratuar për personat që kanë marrë vaksinën e Moderna ose të Johnson & Johnson.

Cilat probleme mjekësore rrisin rrezikun e sëmundjes së COVID-19 të shkallës së rëndë?

Situatat mjekësore që rrisin rrezikun e COVID-19 të rënduar përfshijnë diabetin, problemet e zemrës,

sëmundjen kronike të veshkave, sëmundjen kronike të mushkërive, sëmundjen e mëlçisë, kancerin, demencën, HIV dhe shtatzëninë. Për një listë të plotë, shikoni: [cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/need-extra-precautions/people-with-medical-conditions.html](https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/need-extra-precautions/people-with-medical-conditions.html)

Kush është në rrezik të shtuar ekspozimi ndaj COVID-19 në ambientin e punës apo ambiente të tjera?

Punët që mund të rrisin rrezikun e ekspozimit ndaj COVID-19 përfshijnë punonjësit shëndetësorë, mësuesit, personelin e kopshteve dhe punonjësit e restoranteve dhe të ushqimoreve. Ambiente të tjera ku mund të ketë rrezik të shtuar ekspozimi përfshijnë strehët për të pastrehët dhe burgjet.

Si ta di nëse kam nevojë për vaksinë përforcuese?

Flisni me ofruesin tuaj shëndetësor nëse keni pyetje a duhet të bëni vaksinë përforcuese. Nëse ju duhet ndihmë për të gjetur një ofrues, telefonojini nr. 311.

A mund të marrin përforcim gratë shtatzëna, që ushqejnë me gji apo që po përpiqen të mbesin shtatzëna?

Gratë shtatzëna dhe që kanë qenë së fundi me shtatzëni janë në rrezik të shtuar zhvillimi sëmundjesh nga COVID-19 në krahasim me gratë joshatzëna. Gratë shtatzëna duhet të vaksinohen kundër COVID-19. Nëse gratë shtatzëna përmbushin kriteret e kualifikimit, duhet të marrin një përforcues.

Cilat janë rreziqet e kryerjes së vaksinës përforcuese?

Për shumë njerëz që kanë marrë dy doza të vaksinës së Pfizer, përfitimet e kryerjes së një vaccine përforcuese i tejkalojnë rreziqet e mundshme. Deri më sot, reaksionet e raportuara pas kryerjes së një doze të tretë kanë qenë të ngjashme me ato pas dy dozave të para. Lodhja dhe dhimbja e krahëve kanë qenë efektet anësore të raportuara më zakonisht. Shumica e efekteve anësore kanë qenë nga të lehta deri në mesatare. Efektet anësore janë të rralla, por mund të ndodhin pas një doze përforcuese.

A është kjo vaksinë përforcuese e njëjtë me dy dozat e para?

Po. Vaksina përforcuese e Pfizer është e njëjta vaksinë dhe dozë si me dy dozat e para.

Kur duhet ta bëj vaksinën përforcuese?

Vaksinën përforcuese duhet ta bësh gjashtë a më shumë muaj pasi të kesh marrë dozën e dytë të vaksinës së Pfizer kundër COVID-19.

Nëse na duhet një vaksinë përforcuese, a do të thotë kjo se vaksinat nuk funksionojnë?

Jo. Vaksinat kundër COVID-19 po funksionojnë mirë në parandalimin e sëmundjes së rëndë, shtrimit në spital dhe vdekjes, madje edhe kundër variantit Delta në qarkullim të gjerë. Por, ekspertët e shëndetit publik po fillojnë të shikojnë reduktime në mbrojtje, sidomos në popullata të caktuara.

Unë jam i imunokompromentuar dhe kam kryer një dozë të tretë të vaksinës. A duhet ta kryej edhe vaksinën përforcuese?

Jo. Nuk ka rekomandim për të marrë një dozë të katërt për momentin. Për informacion për dozat e treta për personat që janë të imunokompromentuar mesatarisht deri dhe rëndë, vizitoni [nychealthandhospitals.org/covid-19-vaccines](https://www.nychealthandhospitals.org/covid-19-vaccines).

Ku mund ta kryej vaksinën përforcuese falas?

Vaksinat përforcuese të Pfizer ofrohen në të 11 spitalet e sistemit NYC Health + Hospitals. Nuk ka nevojë të shkoni tek e njëjta pikë ku keni marrë dy dozat e para të vaksinës së Pfizer. Vizitoni cilindo spital kujdesi akut të NYC Health + Hospitals për përforcimin tuaj, planifikoni një takim për vaksinën përforcuese te [covid19.nychealthandhospitals.org/COVIDVaxEligibility](https://www.covid19.nychealthandhospitals.org/COVIDVaxEligibility) ose telefononi në nr. 1-877-829-4692 për ndihmë në shumë gjuhë. Vaksinat përforcuese të Pfizer nuk ofrohet në qendrat e NYC Health + Hospitals/Gotham Health.

A mund ta kryej vaksinën përforcuese në të njëjtën kohë me vaksina të tjera (si p.sh. vaksina e gripit)?

Po. Kryerja e vaksinës përforcuese njëherësh me vaksinat e tjera apo kurdo më para apo më pas është e sigurt. Nëse nuk e keni kryer ende vaksinën tuaj të gripit, të dyja ofrohen në qendrat spitalore të kujdesit akut të NYC Health + Hospitals.

A më duhet një vaksinë përforcuese për të qenë plotësisht i vaksinuar?

Jo. Njerëzit konsiderohen plotësisht të vaksinuar dy javë pas dozës së dytë të vaksinës (si p.sh. Pfizer ose Moderna) ose dy javë pas dozës teke të vaksinës Johnson & Johnson.

A do të bëhen me detyrim vaksinat përforcuese?

Detyrimi i shtetit të Nju-Jorkut për punonjësit e shëndetësisë vlen vetëm për dozën e parë dhe të dytë. Detyrimi nuk përfshin vaksinat përforcuese.